



Datë: 07.11.2025
Numër Protokolli: 7242/2025

A.nr.1660/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, si procesmbajtëse, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1660/2025, të datës 04.09.2025, të parashtruar nga ankuesja L.I-K, kundër organit të punësimit: Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1660/2025, e datës 04.09.2025, e parashtruar nga ankuesja L.I-K, ashtu që, **detyrohet** Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë shqyrtimin e kërkesës me Nr.14-117/01-999564/25, të datës 10.07.2025, të parashtruar nga ankuesja dhe të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, L.I-K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 04.09.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit lidhur me kërkesën me Nr.14-117/01-999564/25, të datës 10.07.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 15.09.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa, ky i fundit, më datë 23.09.2025, ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen përkatëse ankimore.

Kolegji i Këshillit pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e ankueses, atëherë, ekziston baza ligjore që të detyrohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës të datës 10.07.2025 të parashtruar nga ankuesja, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë rrjedhë së ankuesja është e punësuar në Komunën e Prishtinës dhe se e njëjta sipas Akt emërimit me numër Nr.112-835, të datës 01.02.2017, mbanë pozitën e punës *“Zyrtare për evidentimin e pronës së paluajtshme”*, në Drejtorinë e Financave, ndërsa, organi i punësimit sipas nenit 102 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më datë 16.11.2024, i ka lëshuar Akt emërimit me numër Nr.01-112-835, ashtu që pozitën e ankueses *“Zyrtare për evidentimin e pronës së paluajtshme”*, e ka klasifikuar në kategorinë Profesional 2, me klasë dhe koeficient të pagës GJ33(5.1).

Ankuesja më datë 10.07.2025 i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, përmes shkresës me numër protokoli Nr.14-117/01-113105/25, për kompensim material sipas koeficientit të pagës 5.1-GJ33, duke i u referuar Aktit të emërimit të lëshuar më datë 16.11.2024. Po ashtu, ankuesja në kërkesën në fjalë pretendon se është duke u paguar sipas koeficientit 4.50, GJ41-4, klasa Profesional 3, ndërsa sipas shkresave të lëndës konstatohet fakti se organi i punësimit ka heshtur lidhur në kërkesën e ankueses të datës 10.07.2025.

Kundër heshtjes administrative të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi pretendimin ankimor se e njëjta është duke u dëmtuar financiarisht, pasi që pavarësisht faktit se organi i punësimit i ka lëshuar Aktin e emërimit e ri në kategorinë Profesionale 2 me koeficientin e pagës (5.1), nuk është duke u kompensuar sipas koeficientit të përcaktuar. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar si dhe ta obligoj organin e punësimit që të zbatoj Aktin e emërimit me numër Nr.01-112-835 të datës 16.11.2024, si dhe të bëj kompensimin e dëmit të shkaktuar me qëllim të rimbursimit të mjeteve financiare.

Ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje referuar: LPPA), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: 2. *Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure*. 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj*, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes*, andaj, mbi këtë përcaktim ligjor.

Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me Kërkesën Nr. Nr.14-117/01-999564/25, të datës 10.07.2025, të parashtruar nga ankuesja, ngase, sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të nxjerr akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, heshtja e organit të administratës, në këtë rast, Njesisë së Personelit të Komunës së Prishtinës në raport me Kërkesën Nr.14-117/01-999564/25, të datës 10.07.2025, cenon të drejtat e ankueses në kuptimin e të drejtave procedurale dhe për rrjedhojë edhe vendosjes në mënyrë meritore, ngase, ashtu sikurse është thënë në arsyetim të këtij vendimi, në kërkesën e parashtruar të organi i punësimit, ankuesja pretendon në realizimin e të drejtës materiale lidhur me pagën.

Kështu që thënë si me sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar në kuptim të shkeljeve procedurale dhe si rrjedhojë detyroj Njesisë së Personelit të Komunës së Prishtinës, që në respektim të dispozitave procedurale të shqyrtoj Kërkesën Nr.14-117/01-113105/25, të datës 01.08.2025, dhe të nxjerr akt administrativ në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshillë Juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1660/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, L.I- K;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.